




Pranuar / Dorezuar Primiheño/Prodato Received/Delivered	13.01.2023	3	viti qori year
Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPRINTAK	326/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1079/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1079/2022 të datës 01.02.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi fshati Varosh, Komuna e Ferizaj, kundër organit të punësimit/Komuna e Ferizajit, në çështjen juridike-administrative "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 13.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1079/2022 të datës 01.12.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datën 30.11.2022 përmes Postës së Kosovës ka parashtruar ankesën me numër protokolli 7525/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshill është pranuar me datën 01.12.2022, lidhur me ri shpalljen e konkursit të datës 24.11.2022 për pozitën Drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "Gjon Serreqi" në Ferizaj, me pretendimet ankimore që konkursi në fjalë të anulohet dhe të vazhdohet procedura e vlerësimit të performancës dhe i njëjti ka kërkuar që t'i vazhdohet vlerësimi i performancës si drejtor, proces ky i garantuar me ligj me ç' rast DKA-ja në Komunën e Ferizajt pa të drejtë duke bërë shkelje ligjore e ka ndërprerë në gjysmë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 01.12.2022 me Nr.protokolli 7525/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës

30.12.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen ne ankesë të datës 16.12.2022 nga Komuna e Ferizajt së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Konkursin e datës 24.11.2022 me numër 474/2022 nga Komuna e Ferizajt; Vendimin me numër 07 Nr.276 të datës 10.08.2022 nga Komuna e Ferizajt.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Sipas vlerësimit të shkresave të lëndës rezultoi se Komuna e Ferizajt me datën 24.11.2022 ka rishpallur konkursin për pozitën e punës "Drejtor" në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (SHFMU) "Gjon Serreqi".

Në bazë të provave të lëndës rishpallja e konkursit të datës 24.11.2022 për pozitën "Drejtor" në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (SHFMU) Gjon Sereqi i shpallur nga Komuna e Ferizajt, është bërë mbi bazën e nenit 67 dhe 68 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 20 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, nenit 23 të Ligjit Nr.04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr.151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Institucionit Rregullimin e Procedurave të Konkursit të Sektorit Publikë, Para universitar në Republikën e Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të pranushmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik përkatësisht nenit 2 paragrafit 3 dhe 4 ku përcaktohet se 3. *Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë.* 4. *Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se zyrtarët publikë të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të institucioneve publike të kulturës respektivisht pozita "Drejtor" në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (SHFMU) Gjon Sereqi i shpallur nga Komuna e Ferizajt, nuk hynë në kategorinë e nëpunësve civilë, mirëpo hyn në kuadër të nëpunësve të shërbimit publik.*

Bazuar si më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i'u referuar dispozitave të lartcekura, dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbim Civil, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1079/2022 të datës 01.12.2022 të parashtruar nga ankuesi . . .



Si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas nenit 24 paragrafi 4 dhe nenit 74 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se zyrtarët publik me status të nëpunësit të shërbimit publik, kanë të drejtë të ankohen tek punëdhënësi e pastaj mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1079/2022, datë 13/01/2023.

Sabile Avdyli
Sabile Avdyli
Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Arben MEHMETI
Arben Mehmeti
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Ferizajit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

